

VENDIM
Nr. 759, datë 12.12.2022

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE TË MARRËVESHJES SË
RINOVUAR PËR PARTNERITETIN STRATEGJIK NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHOQËRISË “MICROSOFT
CORPORATION”, MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 55, DATË 3.2.2021, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”, dhe të nenit 7, të aktit normativ nr. 18, datë 9.12.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9880, datë 25.2.2008, “Për nënshkrimin elektronik”, të ndryshuar”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së rinovuar për partneritetin strategjik ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë “*Microsoft Corporation*”, miratuar me vendimin nr. 55, datë 3.2.2021, të Këshillit të Ministrave, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Fondi total prej 2 392 794 278 (dy miliardë e treqind e nëntëdhjetë e dy milionë e shtatëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e dyqind e shtatëdhjetë e tetë) lekësh pa TVSH, për realizimin e ndryshimit të projektit të partneritetit strategjik në fushën e teknologjisë së informacionit të përballohet nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit.

3. Autorizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit për të lidhur marrëveshjet e parashikuara për zbatimin e projektit strategjik, sipas përcaktimeve në marrëveshjen ndryshuese të marrëveshjes së rinovuar për partneritetin strategjik, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

**Marrëveshje ndryshuese
e Marrëveshjes së Partneritetit Strategjik**

E nënshkruar më **09.12.2022** nga dhe ndërmjet:

Microsoft Ireland Operation Ltd., një shoqëri e regjistruar në Irlandë, me seli në One Microsoft Place, South County Business Park, Leopardstown, Dublin 18 D18 p521, në vijim i referuar si “MIOL”

dhe

Microsoft Albania Shpk., një shoqëri e regjistruar në Shqipëri, me seli në Tiranë, Rr. “Papa Gjon Pali II”, Qendra e Biznesit ABA, nr. 1205, në vijim e referuar si Microsoft,

dhe

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, Dëshmorët e Kombit, Tiranë, Shqipëri, e përfaqësuar nga Znj. Mirlinda Karcana, Drejtore e Përgjithshme, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, në vijim e referuar si “Këshilli i Ministrave”

(Në vijim referuar individualisht si “Pala” dhe bashkërisht si “Palët”)

Duke marrë në konsideratë Marrëveshjen e Partnerit Strategjik të nënshkruar nga Palët më.....
(në vijim e referuar si “SPA”)

Duke marrë në konsideratë bashkëpunimin e zhvilluar ndërmjet Palëve që nga nënshkrimi i SPA-së;

Duke marrë në konsideratë se Palët dëshirojnë të zgjerojnë bashkëpunimin;

Palët bien dakord si vijon:

1. Në pikën 4 të SPA-së **“ROLET E PARASHIKUARA TË PALËVE”**, titulli i nënpikës 4.1.1 “Microsoft me qëllim mbështetjen e Axfordës Digjitale 2020-2024”, ndryshohet në “Microsoft me qëllim mbështetjen e Agjendës Digjitale 2022-2026 të miratuar me Vendim Nr.370, datë 1.6.2022 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strategjisë ndërsektorale “Agjenda Digjitale e Shqipërisë” dhe të planit të veprimit 2022–2026”.

2. Në nënpikën 4.1.1, të pikës 4 të SPA-së do të shtohet/ shtohet fusha e mëposhtme e bashkëpunimit:

Modernizimi dhe Transformimi. Microsoft-i do të alokojë burime, mjete dhe veprimtari parashikimi shtesë drejt një programi për ta bërë transformimin dixhital të Qeverisë më elastik. Microsoft-i do të ndihmojë në modernizimin e strategjisë që është i harmonizuar me synimet, strategjinë, rreziqet, tolerancën ndaj rrezikut dhe tendencat e Qeverisë. Microsoft-i së bashku me Qeverinë do të krijojnë një plan veprues transformimi, i cili do të modernizojë arkitekturën e Qeverisë dhe Qendrën e Operacioneve të Sigurisë, bazuar në rekomandimet e Microsoft-it dhe arkitekturat referuese, duke përfshirë qasjen Zero Trust (Zero Besim).

3. Pjesa e mbetur e dispozitave të SPA-së mbetet e pandryshuar.

Data:

Microsoft Ireland Operation Ltd

Nga:


.....
Microsoft Albania shpk

Nga:

Këshilli i Ministrave

Nga:


.....
